

Paraqitja, lindja dhe zhvillimi i shkencës së Historisë së Feve

Mr. Qani NESIMI¹

I. Historia e Feve dhe definicioni i saj

Historia e Feve, siç kuptohet edhe nga vetë termi, është një shkencë e cila merret me historikun, përshkrimin dhe definimin, me natyrën, gjenezën dhe me zhvillimin e asaj që e manifestojnë sjelljet-traditat fetare të njeriut në vend dhe kohë të limitizuar/caktuar. Metoda e Historisë së Feve bazuar në dokumentacione filologjike. Ajo çështjeve të studimit të saj-personaliteteve të shquara, teksteve të shenjta dhe proceseve të historike-u kushton rëndësi të veçant, si në aspektin historik, gjeografik ashtu edhe në aspektin historiko-kulturorë. Me fjalë tjera, studimi në këtë fushë, para çdo gjeneralizmi dhe gjykimi teorik, mbështetet në pyetjet “kur”, “kush”, “ku”, dhe “si”.²

Historia e Feve, si çdo shkencë historike, çështjes i afrohet duke u nisur nga ngjarjet dhe hollësitë historike. Për këtë ajo në fillim nuk merret me problemet gjenerale të fesë, por ajo, për të definuar procesin historik në lidhje me ekzistencën e njeriut, merret me studimin e rrethit, kohës, objekteve dhe ngjarjeve individuale. Prandaj Historia e Feve nuk duhet të ngatërohet me Historinë e Fesë, e cila merret vetëm me disa aspekte të vetëm një feje, ndërsa është shumë larg interesimit për problemet universale historike dhe fenomenologjike të feve në përgjithësi. Kurse, problemet univerzale historike dhe fenomenologjike janë çështje themelore me të cilat merret Historia e Feve.

Disa dijetarë bashkëkohor;, me plotë të drejtë Historinë e Feve e definojnë si Histori Krahasese të Feve. Për arsye se ajo, Historia e Feve, nuk është thjeshtë vetëm një studim historik, por, në të njëjtën kohë është edhe studim historik krahasues. Këtu nuk mund të përjashtohen tipologjia e njohur historike dhe ligjet e mundësitë e saja imanente. Ajo i studion proceset individuale, të cilave iu dihet e

¹ Autori, përveç botimit në fjalë ka të botuar edhe këta punime shkencore: *Dialogu-nevojë e përhershme, Burimet kryesore të etikës Islame të pandryshueshme dhe autentike, Arnavut Ootosefal Ortodoks Kilisesi'nin (AOOK) Kuruluđu ve Fener Patrikhanesi* (në turqishte), *Islami dhe Toleranca, Njeriu dhe mileniumi i ri*. Ndërsa në të ardhmen priten të botohen edhe punime të tjera shkencore të autorit në fjalë.

² Bianchi, Ugo, *Dinler Tarihi Araştırma Yöntemleri*, (turq. përkth. Mustafa Unal), Kajseri: Geçit 1999, f.1-2.

kaluara. Vetëm se ajo, ka kujdes të veçant në të kuptuarit e vërtetësisë së zhvillimit të këtyre proceve në rrethin ku ata zhvillohen dhe në të kuptuarit e të gjitha problemeve me ndikim historik.³

Gjithashtu Historia e Feve është definuar edhe si një komentim i tërësishëm e jo parcial i feve. Sepse ajo thirret që të nxjerr në pah dhe të studioj çdo lloj ballafaqimi të njeriut me të shenjtën, prej parahistorisë e deri më sot. Por, për Historianët e Feve është një modesti apo një turp i madh, thotë M. Eliade, që të jenë të dyshimtë në vlerësimin kulturor të rezultateve të nxjerra nga studimet e bëra në këtë fushë. Për këtë edhe, prej Max Müller dhe Andrew Lang e deri te Frazes dhe Marett, e prej Marett dhe Levy-Bruhl e deri më sot, vërejmë rënien graduale të krijimtarisë apo të aktualitetit të Historisë së Feve. Por, autori në fjalë vazhdon duke thënë se, nuk është e pamundur që Historia e Feve të rikthehet përsëri në pozitën e saj qendrore. Vetëm se për këtë Historianët e Feve duhet të besojnë në mundësitë e pakufizuara (e shumta) në këtë drejtim dhe, gjithashtu, duhet që të mos neglizhojnë dhe të jenë të vetëdijshëm për madhësitë dhe peshën e fushës në fjalë. Po ashtu Historianët e Feve duhet larguar edhe nga arsyet që e pasivizojnë në këtë drejtim si, në atë se nuk janë grumbulluar të gjithë dokumentacionet dhe se nuk janë bërë komentime të përshtatshme etj.⁴

Sipas studimeve historike Historia e Feve është një disiplinë e cila, duke përdorur metodat historike dhe filologjike, studion lindjen, zhvillimin, ibadetet, ahlakun-etikën etj., e feve përgjatë historisë. Ndërsa sipas studimeve krahasuese Historia e Feve është degë e shkencës e cila krahason aspektet e përbashkëta, të ngjashme dhe të ndara mes feve.⁵

Historia e Feve nuk përjashton asnjë cilësi-specifikë të esencës fetare. Sepse esenca fetare mund të kuptohet edhe prej studimit historik krahasues, që d.t.th., prej fenomenologjisë së bazuar në studimin historik-konstruktiv. Historia e Feve fenomenet, të cilat vlerësohen si fetare, i studion në bazë të metodave studiuuese të Historisë së Feve, pa marrë parasysh se njerëzit i pëlqejnë apo nuk i pëlqejnë ato.⁶

Ndërsa sipas Annamarie Schimmel-it Historia e Feve në vete ngërthen të gjitha fetë në përgjithësi, të cilat i ndanë në fe primitive, fe kombëtare-nacionale dhe në fe botërore. Koncepti fe primitive ka një përfshirje shumë të gjerë; ajo përfshinë të gjitha fetë primitive, duke filluar nga niveli më i ulët i popujve pigmenë afrikanë e deri te niveli më i lartë zezak, ose deri te popujt polinezë. Të gjitha këto fe kanë anët e tyre të përbashkëta, kështu që, për studimin e tyre lind nevoja për ndihmën e etnologëve, filologëve dhe sociologëve. Koncepti fe kombëtare përfshinë fetë e kohës antike si fenë e vjetër greke, romake, gjermane, kelte, kineze, egjiptiane, hitite dhe asure. Këto fe janë pasuri shpirtërore vetëm e një populli dhe nuk e tejkalojnë kufirin e popullit-kombit që i takojnë. Ndërsa koncepti fe botërore, sipas autorit, përfshinë Hebreizmin, Krishterimin dhe

³ Po aty, f.3.

⁴ Eliade, Mircea, **Dinin Anlamı ve Sosyal Fonksyonu**, Konja: Din Bilimleri Yayınları 1995, f.69-70.

⁵ Tümer, Günay dhe Abdurrahman Küçük, **Dinler Tarihi**, Ankara: Ocak 1993, f.10.

⁶ Bianchi, vep. e cit., f.4.

Budizmin.⁷ Obligimi ynë (i Historianëve të Feve), thotë autori, është që të pyesim dhe të kërkojmë se në cilët kushte ka ndodhur ky zbulim.⁸

Përveç Schimmel-it, me grupimin apo klasifikimin e feve në përgjithësi janë marrë edhe disa dijetarë tjerë të Historisë së Feve. Kështu që Joachi Wach fetë i ndanë në “fe që kanë themelues” dhe “fe tradicionale”, ndërsa Gustave Menschinf fetë i klasifikon në “fe kombëtare-nacionale” dhe në “fe univerzale”. Kurse disa dijetarë muslimanë fetë i ndajnë në “fe të vërteta” dhe në “fe jo të vërteta”, apo në “fe që bazohen në shpallje” dhe në “fe botërore-natyrore”. Sipas këtij klasifikimi të vërteta quhen ato fe, të cilat etikën dhe kënaqësinë e tyre e bazojnë në besimin në All-llahun, Zot të Vetëm. Ndërkaq fe jo të vërteta quhen ato fe të cilat nuk i posedojnë këto cilësi. Në literaturën Islame grupi i parë quhet me emrin *milel*, ndërsa grupi i dytë me emrin *nihal*. Shembulli më i mirë për këtë janë veprat e Shehristanit dhe Bagdadit.⁹ Përveç këtij klasifikimi ka edhe klasifikime tjera të bëra nga dijetarë të ndryshëm të lëmit në fjalë, por të gjitha klasifikimet përafërsisht, vetëm se me fjalë të tjera, shprehin të njëjtën gjë.

Historia e Feve përveç që njihet me këtë emër, në literaturën e saj njihet edhe emra tjerë si Shkenca Fetare, Fenomenologjia Fetare, Religjionet Komparative-Fetë Krahasuese, Historia e Religjioneve Krahasuese.¹⁰ Por, kjo lëmi më së shumti njihet me emrin Historia e Feve, ku në vete ngërthen të gjitha metodat dhe mënyrat e studimit të të gjithë emrave të përmendur më lartë. Kjo nuk do të thotë se Historia e Feve është e njëjtë me ta, por ndoshta në të ardhmen do të vijë deri te ajo sa që edhe Historia e Feve, por edhe Fenomenologjia Fetare dhe Religjionet Komparative të jenë të ndara njëra prej tjetrës. Ndërsa për momentin kur përmendim njërën mund të përkujtojmë tjetrën, ndërsa kur përmendim tjetrën mund të përkujtojmë të parën dhe kështu me rradhë.

II. Formimi i shkencave fetare dhe pavarësimi i Historisë së Feve në Perëndim

Në shek. XVIII. dhe shek. XIX. me emrin Shkencat Humane (Njerëzore) janë formuar tre grupe shkencash. E para është shkenca, në të cilën bëjnë pjesë matematika, fizika dhe mekanika. E dyta është biologjia, në të cilën bëjnë pjesë zoologjia, antropologjia, palentologjia dhe pre(para)historia. Ndërsa e treta është kultura dhe historia, të cilat më vonë e kanë marrë emrin shkenca humane (njerëzore).

Në shek. e XVI. ndodhën schizma (ndarja e Protestantizmit) e dytë në Krishterim dhe zbulimi i botës së re. Këto të dyja luajtën rol të rëndësishëm në nxjerrjen në shesh të një mendimi të ri fetarë dhe kështu që ky mendim u orientua drejt popujve greko-romen dhe zotërave të Egjiptit dhe Finikesë. Më vonë (XVII)

⁷ Fe e pakifizuar në një komb dhe që vlenë për tërë botën, e që në vërtetë si tillë është e vetme, është feja Islame, të cilën autori nuk e përmend në këtë klasifikim.

⁸ Schimmel, Annamarie, **Dinler tarihine giriş**, Stamboll: Kırkambar 1999, f.6.

⁹ Günay dhe Tümer, vep. e cit., f.11.

¹⁰ Bianchi, vep. e cit., f.24.

misionarët xhizvitë filluan aksionet e tyre kah kultura kineze, indiane dhe Amerika Latine. Në shek. XVIII. Vico (*Scienza Nuova*), J.F.Latifau (*Moeurs des savuvages ameriquains*) dhe Charles de Brosses (*Du culte des dieux fetiches*) me veprat e tyre bëjnë një hap të rëndësishëm në këtë drejtim.¹¹

Pas Revolucionit Francez u bënë shumë hulumtime në lidhje me të kaluarën si dhe u bënë edhe shumë zbulime. U bë zbulimi i mbeturinave (fosileve) parahistorike, i civilizimit iranien, egjiptian dhe feve indiane. Kështu që lindën shkencat si Arkeologjia, Filologjia, Orientalizmi dhe Etnografia. Me shtimin e dokumenteve të tilla lindi nevoja për klasifikimin e tyre, kështu që, lindi edhe shkenca Kritika Historike dhe Filologjia Komparative. Max Müller (1823-1900) është njëri prej atyre të cilët janë marrë me Filologji Krahësuese.¹²

Në shek XIX. filluan hulumtimet parahistorike, që mundësuan nxjerrjen në pah të shumë dokumenteve për periudhën e më hershme. Më vonë, nga kolonizimi në shesh doli etnografia, e cila njeriut përëndimor ia mësoi fenomenet fetare të popujve të ashtëquajtur primitivë. Një studim i tillë i feve në plan të parë nxorri termin e gjenezës dhe të zhvillimit dhe bëri komentime të ndryshme në lidhje me ta (si animizmi, totemizmi, mana etj.). Edhe skema biologjike e Darvinit u bartë në hulumtimet për gjenezën dhe zhvillimin e fesë. Por, në anën tjetër u paraqit edhe reaksioni ndaj teorisë dhe sqarimeve evolucionare. Disa etnolog si Andrew Lang dhe W. Schmidt, zbuluan mbeturinat e Urkultur-it të civilizimit arkaik, i cili civilizim dëshmon për besimin në një ekzistencë transcendentale. Ndërkaq më vonë studimi i feve në përgjithësi u bë edhe lëmi në vete. Në Holandë C.P. Tiele (1830-1902) bashkë me mendimtarët që ai i udhëhiqte, në vend të teologjisë zgjodhën shkencën e Historisë së Feve. Në Oxford me Max Müller-in, ndërsa në Kopenhag dhe Gjenevë, duke filluar që nga viti 1873, u zhvillua lënda Historia e Feve.¹³ Përveç kësaj sipas Otto Pfleiderer-it (në Berlin) shkenca e feve duhet të jetë historia e të gjitha feve. Kjo gjë filloi të paraqitet edhe në Francë. Në *College de France* u formua lënda Historia e Feve, e cila iu dorëzua Albert Reville-së. Në këtë lëvizje morri pjesë edhe Ernest Renan (1823-1892). Kështu që brenda njëzet viteve (1880-1900) u arritë një hap i rëndësishëm në fushën e Historisë së Feve. U formuan lëndë të Historisë së Feve si në Holandë, në Paris, në Bruksel, në Louvain. Në Paris filluan të dalin revista fetare si *Revue de l'Histoire des religions* dhe *Revue des religions*, në Louvain filloi të dalë *Meseon*-i, ndërsa më 11-23 Shtator 1893 në Çikago u mbajtë tubimi *World's Parliament of Religions*. Sidomos një kthesë të rëndësishme në lidhje me këtë çështje ka bërë kongresi Historia e Feve, i mbajtur në vitin 1900 në Paris.¹⁴ Gjithashtu edhe në Itali në Universitetin e Romës mes viteve 1924-1953, Historia e Feve filloi me R. Pettazzoni-n, i cili më 1925 nxorri revistën me titull *Studie materiali di storia delle religioni*.¹⁵

¹¹ Harman, Ömer Faruk, *Günümüzde Batıda Dinler Tarihi Çalışmaları, Dinler Tarihi Araştırmaları I*, Ankara: Dinler Tarihi Derneği Yayınları 1998, f.315.

¹² Po aty, f.316.

¹³ Bianchi, vep. e cit., f.28; Harman, vep. e cit..

¹⁴ Po aty, f.316-317.

¹⁵ Bianchi, vep. e cit., f.29.

Ndërkaq në kohën më të re si vepra të shkruara në këtë fushë mund të veçohen vepra 16 vëllimëshe e autorit shumë të njohur Mircae Eliade-së *The Encyclopedia of Religion*, e botuar në New York më 1987; vepra e G.Balandier-it *Le Grand Atlas des Religions*, Paris 1988; vepra e Pettazzoni-it *Essays on the History of Religions*, Leiden 1954; *Die Religion in Geschichte und Gegenwart*, botimi 3, v.7, 1956-65; *Itastings*, ERE, 13 v., Edinburg 1908-1926; A.di Nola, (ed.), *Enciclopedia delle religioni*, 6 v., Firenze 1970-1976; J. Reville, *Les phases successives de l'histoire des Religions*, Paris 1909; H. Pinard de la Boullaye, *L'étude comparee des religions*, 2 v., Paris 1922, 1929; U. Bianchi, *The History of Religions*, Leiden 1975; W.C. Smith, *The Meaning and and of Religion*, New York 1962; E.J. Sharpe, *Comparative Religion*, Londres 1986; N. Smart, *The Science of Religion*, Princeton 1973.¹⁶

Këtu mendoj se me rëndësi është të përmendet edhe një gjë se, një prej elementeve penguese në zhvillimin e shkencës në përgjithësi, e të Historisë së Feve në veçanti ka qenë Kisha Katolike, e cila në mesjetë në asnjë mënyrë nuk ka lejuar që njerëzit të merren me fetë tjera. Por, si rezultat i kolonizimit Perëndimi u takua me fetë tjera dhe filloi t'i studioj ato. Një moment tjetër me rëndësi që i dha mundësi studimit të feve tjera ishte edhe reforma e realizuar kundër Kishës.¹⁷

III. Historia e Feve dhe veprat e para në lidhje me të në Islam

Historia e Feve është një prej lëmenjve të cilat shumë më vonë kanë dalë në shesh si lëmë të pavarura. Në botën Islame kjo lëmë në fillim ka qenë bashkë me Filozofinë Fetare dhe Tasavvufin. Krahas Kur'anit dhe Hadithit të të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., që posedojnë disa të dhëna të rëndësishme në lidhje me disa fe si Hebreizmin, Krishterimin dhe Sabiizmin¹⁸, në kohën e Abbasitëve Ibn Mukaffa (723-759) ka përkthyer në arabishte vepra për mitologjinë dhe fenë e vjetër iraniane. Përveç kësaj në arabishte janë përkthyer edhe disa vepra mbi fetë indiane-Keldanijtë si *Kitab-u Medhahib ul-Keldanijjin fi'l Asnam*, *Kitabu Esrar ul-Kevakib*, *Kitabu ul-Kerabin*. Në vitin 330 hixhri Said Fejumi ka përkthyer në arabishte dhe ka komentuar disa pjesë të Tevratit. Më vonë janë përkthyer edhe librat e njohur hebraik me emrin Talmud.¹⁹

Sipas profesor Ahmed Shelebiut, pas kodifikimit të fikhut, tefsirit dhe hadithit në shek. e II. h., në shek. III. h. Ka filluar kodifikimi edhe i disa shkrimeve në lidhje me historinë e feve. Kështu që, Neubahti (viti 202 h.) shkruan librin *el-Arau ved-Dijanat*, el-Mesudi (viti 346 h.) shkruan dy libra lidhje me *ed-Dijanat*, ndërsa el-Mesbehi (viti 420 h.) shkruan veprën *Derkul-bakijjeti fi vasfil-edjani vel-ibadat*.²⁰

Në kuptimin e vërtetë të fjalës, librin e parë në fushën e Historisë së Feve e kanë shkruar Ebu Mensur el-Bagdadi (v.1037) me titull *el-Fark bejne 'l-Firak* dhe

¹⁶ Më gjërësisht shih, Harman, vep. e cit., f.320-321.

¹⁷ Günay dhe Tümer, vep. e cit., f.12.

¹⁸ Kur'an, 2:62, 5:69, 22:17; Më gjërësisht shih, Özsoy, Ömer dhe İlhami Güler, **Konularına göre Kur'an**, Ankara: Fecr Yayınevi 1997, f.148-165.

¹⁹ Sarıkçıoğlu, Ekrem, **Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi**, Isparta, 2000, f.17.

²⁰ Shelebi, Ahmed, **Mukarenetul-edjani'l-Jahudijetu**, v.1, Kairo 1972, f.31.

Ebu Nasr Mutahhir Ibn Tahir el-Makdisi (v.340 h.) me titull *Kitabu'l-Bed'i ve't-Tarih*. Përveç kësaj, Ebu Muzaffer Tahir b. Muhammed Esfarani (v.1078) dhe Kadi Ebu Bekr el-Bakillani (v.1013) kanë shkruar vepra në lidhje me milel dhe nihal. Gjithashtu Ebu Muhammed Ali b. Ahmed b. Hazmi (944-1064) nga Kordoba ka shkruar veprën shumë të rëndësishme katër vëllimëshe me titull *Kitabu'l-Fasl fi'l-Milel ve'l-Ahvali ve'n-Nihal*. Në dy vëllimet e para të kësaj vepre bëhet fjalë për sofistët dhe frakcionet filozofike, për Hebraizëm dhe Krishterim, si dhe për deformimin e Tevratit dhe Inxhilit. Ndërsa në dy vëllimet e fundit bëhet fjalë për Medhhebet Islame. Por këtu është me rëndësi të përmendet se kjo vepër në aspektin metodologjik është më e dobët në krahasim me veprën e më vonshme *el-Milel ve'n-Nihal*, të shkruar nga autori i njohur i kësaj fushe Ebu'l-Feth Muhammed Shehristani (v.1153 m.). Përveç këtyre, ndër veprat më të njohura janë edhe *er-Redd'l-Xhemil li ilahijjeti İsa bi Sarihi'l-Inxhil* të Ebu Hamid Muhammed b. Muhammed el-Gazaliut dhe *el-Asaru'l-Bakije Ani'l-Kuruni'l-Haliye* të el-Biruniut.²¹

Si në gjithë historinë Islame, ashtu edhe në periudhën e më vonshme në Shtetin Osman-e më vonë në Turqi, vepra për historinë e feve, e sidomos vepra për historinë e Pejgamberëve janë shkruar shumë. Por, përveç këtyre dhe veprave të tjera të shkruara në këtë drejtim, janë hapur edhe lëndë mësimore të veçanta në lidhje me këtë shkencë. Në këtë moment mund të përmendim lëndën “*Tarih-i Umumi ve Ilm-i Esatiri'l-Evvelin*”, e cila bënte pjesë në plan programin e vitit shkollor 1874 në *Darü'l-Fünun*. Pas Konstituimit të Dytë (İkinci Meşrutiyet-1908-1918) të qeverisë turke, më 1911 profesorët (muderrisët) e *Sher'ije ve Ulum-i Edebije*, në mbledhjen e mbajtur kanë vendosur që në mes të mësimëve të *Ulum-i Sher'ije*, 6 orë të mbahen me lëndët *Tarih-i Din-i Islam* (Historia e Fesë Islame) dhe *Tarih-i Edjan* (Historia e Feve). Kurse në vitin 1914 në shkollën me emrin *Medresetü'l-Mütehassisin*, e ndërtuar në emër të Abdulhamidit I., shihet edhe prezenca e lëndës *Tarih-i Edjan*. Pas formimit të Republikës së Turqisë çështja e mësimbesimit i është lënë Fakultetit Teologjik në Stamboll. Këtu janë mësuar lëndët *Türk Dinleri ve Mezhepler Tarihi* (Fetë Turke dhe Historia e Medhhebeve) dhe *Dinler Tarihi* (Historia e Feve). Por, për fat të keq ky institut mbyllet më 1936 dhe kjo gjendje vazhdon deri më 1949. Më 1949 në kuadër të Universitetit të Ankarasë hapet Fakulteti Teologjik, në të cilin fakultet ka ekzistuar edhe lënda Historia e Feve. Gjithashtu lënda Historia e Feve ekzistencën e saj e ka vazhduar edhe në plan programet e fakulteteve teologjike, instituteve të larta Islame dhe të shkollave Imam Hatip, të cilat janë hapur më vonë.²²

Ndërsa veprat e shkruara në këtë lëmë në fund të Perandorisë Osmane dhe në fillim të formimit të Republikës së Turqisë mund të përmenden si vijon: vepër më e vjetër llogaritet vepra me emrin *Esatir* e Shemsuddin Sami Frashërit e shkruar më 1878. Më pastaj kemi librin e shkruar më 1911 *Tarih-i Edjan* të autorit Ahmet Mithat Efendi. Gjithashtu më 1912-1915 Mahmud Esad b. Emin

²¹ Aydın, Mehmet, **Dinler Tarihine Giriş**, Konya: Din Bilimleri Yayınları 1996, f.10-11; Shelebi, vep. e cit., f.31; Sarıkçioğlu, vep. e cit., f.17-18.

Sejdishehri shkruan një libër si hyrje në Historinë e Feve me emrin *Tarih-i Edjan*, më 1919 M. Shemseddin shkruan një libër kryekëput për fetë primitive me emrin *Tarih-i Edjan*, më 1935 Hilmi Ömer Budda boton veprën *Dinler Tarihi*. Ndërkaq libri me titull *Yer Yüzündeki Dinler* (Fetë në Rruzullin Tokësorë) i autorit Ömer Rıza Doğrul botohet më 1949. Pas viteve 50-ta si në çdo lëmë ashtu dhe në lëmin Historia e Feve shkruhen vepra të shumta, si dhe në fushën e botimit të veprave në këtë drejtim arrihet një zhvillimi konsiderueshëm. Sa për ilustrim këtu mund të përmendim veprën *Karşılaştırmalı Dinler Tarihi* (Historia e Feve Krahasese) të Mehmet Taplamacıoğlu dhe *Dinler Tarihi Araştırmaları* (Studime në fushën e Historisë së Feve) të Hikmet Tanyu. Në kohën tonë si vepra me vlerë dhe me peshë të botuara në Turqi, nëse do të përmendim vetëm disa prej tyre, do të kishim veçuar veprën *Dinler Tarihi* (1993) të autorëve Günay Tümer dhe Abdurrahman Küçük dhe veprën e Mehmet Aydın-it me titull *Dinler Tarihine Giriş* (Hyrje në Historinë e Feve).²³ Gjithashtu këtu do të kisha përmendur edhe veprën e profesorit të nderuar Ekrem Sarıkçıoğlu-t, *Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi*.

IV. Historia e Feve dhe shkencat tjera

Historia e Feve, si çdo shkencë tjetër, nuk ka mundësi që të jetë plotësisht e pavarur nga shkencat tjera. Por, sado që të jetë, pak apo shumë, lidhshmëria apo varësia e saj me shkencat tjera është e dukshme në shumë aspekte të veprimit të saj. Historia e Feve, e cila është anëtare kryesore e familjes së Shkencës Fetare, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi ka të bëjë me disa shkenca e që janë: *Fenomenologjia Fetare*, *Sociologjia Fetare*, *Psikologjia Fetare* dhe *Filozofia Fetare*.²⁴

Fenomenologjia Fetare; fenomen është një gjë që duket-konkrete, ndërsa fenomenologji do të thotë diskutimi sistematik i gjërave fetare që duken. Dega shkencore e cila në mënyrë sistematike merret me studimin e gjërave që duken është Fenomenologjia Fetare. Fenomenologjia Fetare, pa marrë parasysh zhvillimin historik, diskuton anët e dukshme të fenomenit fetarë. Ajo gjithashtu merret me rregullimin e fenomeneve që në Historinë e Feve duken kaotike; bën rrënditjen në mënyrë më të bukur të tipeve të ndryshme të feve; ajo i paraqet të gjitha anët e përbashkëta të të gjitha feve në përgjithësi. Gjithashtu ajo mundohet të gjejë anët e përbashkëta në mes feve duke studjuar ibadetet, ceremonitë, vendet e shenjta, kohën, gjërat e shenjta dhe personalitetet fetare. Dhe për këtë Fenomenologjia Fetare, duke mos i mohuar ndarjet mes feve, por duke paraqitur çdo specifikë të çdo feje, tregon se të gjithë ndjenjat fetare dhe demonstrimet e tyre janë të njëjta në tërë botën dhe se origjinaliteti dhe qëllimi i të gjithëve

²² Sarıkçıoğlu, vep. e cit., f.20.

²³ Aydın, vep. e cit., f.13.

²⁴ Schimmel në librin e tij përmend edhe *Metafizikën Fetare*. Metafizika Fetare, sipas Annamarie Schimmel-it, merret me vërtetësinë (hakikatini) e konceptit të ekzistencës absolute, të cilën e paraqet Fenomenologjia Fetare dhe me realitetin e marrëdhënieve të njeriut me atë ekzistencë. (Shih, Schimmel, vep. e cit., f.9)

(fetarëve në botë) është i njëjtë. Kështu që Fenomenologjia Fetare materialin e saj e merr nga Historia e Feve. Vetëm se ajo këtë material nuk e studjon në aspektin historik por në aspektin sistematik. Fenomenologjia fetare edhe pse në disa pika është e njëjtë me disa shkencë tjera, përsëri ka anët e saja specifike.²⁵

Sociologjia Fetare; Sociologjia Fetare është degë e posaçme e Sociologjisë dhe detyra e parë e saj është që të studioj gjendjen dhe strukturën e shoqërive fetare, të cilat paraqesin një tip të veçantë të organizimit dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore e që si të tilla i janë të përshtatshme studimit sociologjik. Ndërsa detyra e dytë e saj është që të studioj ndikimin e fesë në shoqëri dhe ndikimin e shoqërisë në fe.²⁶ Kjo shkencë merret me studimin, komentimin dhe vlerësimin sociologjik të fesë. Kjo degë e Sociologjisë, gjithashtu, studion sistemin e besimit të feve, format e adhurimit, organizatat fetare, dukuritë shoqërore dhe kushtet në të cilat ato pësojnë ndryshime, format e ndryshimit shoqërore, marrëdhëniet e fesë me klasat shoqërore, organizatat dhe grupet e ndryshme fetare dhe llojet e ndryshme të etikës-moralit fetar. Me fjalë të tjera Sociologjia Fetare fenë më tepër e studion si themelat shoqërore dhe mundohet të sqaroj funksionin shoqëror të saj.²⁷ Detyra parësore e Sociologjisë Fetare është, që duke e përdorur metodën dhe teknikën e Sociologjisë së përgjithshme, të studioj ndikimin reciprok të marrëdhënieve mes strukturës/përbërjes socio-kulturore të shoqërisë dhe fesë, të cilën e posedon ajo shoqëri.²⁸

Psikologjia Fetare; kjo shkencë fenë e shiqon nga këndi psikologjik. Kështu që ajo studion çdo lëvizje apo sjellje shpirtërore me karakter fetarë të njeriut. Si tema kryesore të Psikologjisë Fetare mund të numërohen aftësia fetare, interesimi dhe dëshira fetare, ndjenjat dhe përvoja fetare, besimi dhe qëndrimet/sjelljet fetare, lutjet dhe ibadetet, tevbeja-pendimi dhe udhëzimi, largimi prej fesë dhe pabesimi, jeta mistike dhe tasavvufi etj. Ndërsa qëllimi i kësaj lëmi është që anën fetare të njeriut ta studioj me tërë gjërësinë dhe thellësinë e saj dhe aq sa është e mundur të nxjerrë njohuri objektive shkencore.²⁹

Filozofia Fetare; Filozofia Fetare mundohet që fesë t'i gjejë një bazë filozofike. Kjo degë e Filozofisë temë parësore të saj ka studimin kritik, logjik, sistematik dhe objektif të vetë fesë, llojeve dhe formave të ndryshme të saj-duke filluar nga fetë primitive si animizmi, totemizmi etj. e deri te fetë monoteiste si Hebraizmi, Krishterimi dhe Islami- koncepteve dhe pretendimeve themelore të saj.³⁰ Prandaj qëllimi i atyre të cilët merren me këtë lëmë nuk është që të tregojnë se kjo fe është e vërtetë, e kjo nuk është e vërtetë. Por, ata synojnë paraqitjen e anës logjike të rregullave fetare. Filozofia Fetare merret me esencën e fesë dhe lidhjet e njeriut me të vërtetat fetare. Ndër temat kryesore që i diskuton Filozofia Fetare mund të numërohet ekzistenca e All-llahut, cilësitë e Tij, marrëdhëniet All-

²⁵ Schimmel, vep. e cit., f.6-7; Günay dhe Küçük, vep. e cit., f.13.

²⁶ Pavićević, Vuko, **Sociologjia Religije**, Beograd 1988, f.57-58.

²⁷ Er, Izzet, **Din Sosyolojisi**, Ankara: Akçağ 1998, f.8.

²⁸ Po aty, f.9.

²⁹ Hökelekli, Hayati, **Din Psikolojisi**, Ankara: Türkiye Diyanet Vakfı 1996, f.7-9.

³⁰ Arslan, Ahmet, **Felsefeye Giriş**, Ankara: Vadi 1994, f.144.

llah-botë, krijimi, qëllimi i ekzistencës së botës, ringjallja, pejgamberllëku dhe shpallja-vahji. Me një fjalë Filozofi Fetare d.t.th. qasje filizofike fesë, apo më mirë thënë ajo është diskutim dhe mendim për fenë.³¹

Që të kihet sukses në Historinë e Feve duhet të njihet gjuha për të realizuar vlerësimin e teksteve fetare. Kështu që, në këtë rast, Historisë së Feve përveç lëmëve të lartpërmendura, i nevojitet edhe shkenca e cila do t'i ndihmojë në njohjen e gjuhës e që është Filologjia. Sidomos, për studime në fushën e Historisë së Feve shfrytëzohen edhe Mitologjia, Etnologjia, Historia e Artit, Folklori dhe shumë shkenca të tjera të ngjashme me to.

Bibliografia

- Arslan, Ahmet**, *Felsefeye Giriş*, Ankara: Vadi 1994.
- Aydın, Mehmet S.**, *Din Felsefesi*, Ankara: Selçuk Yayınları 1994.
- Aydın, Mehmet**, *Dinler Tarihine Giriş*, Konya: Din Bilimleri Yayınları 1996.
- Bianchi, Ugo**, *Dinler Tarihi Araştırma Yöntemleri*, Kajseri: Geçit 1999.
- Eliade, Mircae**, *Dinin Anlamı ve Sosyal Fonksyonu*, Konja: Din Bilimleri Yayınları 1995.
- Er, İzzet**, *Din Sosyolojisi*, Ankara: Akçağ 1998.
- Harman, Ömer Faruk**, "Günümüzde Batıda Dinler Tarihi Çalışmaları", *Dinler Tarihi Araştırmaları I.*, Ankara: Dinler Tarihi Derneği Yayınları 1998.
- Hökelekli, Hayati**, *Din Psikolojisi*, Ankara: Türkiye Diyanet Vakfı 1996.
- Özsoy, Ömer** dhe **İlhami Güler**, *Konularına göre Kur'an*, Ankara: Fecr Yayınevi 1997.
- Pavićević, Vuko**, *Sociologija Religije*, Beograd 1988.
- Sarıkcıoğlu, Ekrem**, *Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi*, Isparta, 2000.
- Schimmel, Annamarie**, *Dinler tarihine giriş*, Stamboll: Kırkambar 1999.
- Shelebi, Ahmed**, *Mukarenetul-edjani el-Jahudijetu*, v.1, Kairo 1972.
- Tümer, Günay** dhe **Abdurrahman Küçük**, *Dinler Tarihi*, Ankara: Ocak 1993.

³¹ Aydın, Mehmet S., **Din Felsefesi**, Ankara: Selçuk Yayınları 1994, f.2; Günay dhe Küçük, vep. e cit., f.15.